

LIGJ
Nr.9750, datë 4.6.2007

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.9072, DATË 22.5.2003
“PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 46 shkronja “c”, në fund të fjalisë shtohen fjalët “dhe vendos masat administrative për mospërmbushjen e tyre, sipas nenit 46/1”.

Neni 2

Pas nenit 46 shtohet neni 46/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 46/1

1. Lidhja elektrike pa kontratë, lidhja elektrike para aparatit matës dhe cenimi i vulave ose dëmtimi i sistemit matës të energjisë elektrike nga përdoruesit familjarë, kur këto shkelje nuk përbëjnë veprë penale, dënohen me gjobë si më poshtë:

- a) për lidhje abuzive para sistemit matës, nga 1 000 deri në 5 000 lekë;
- b) për cenim të sistemit matës dhe të vulave të tij, nga 1 000 deri në 10 000 lekë;
- c) për lidhje në rrjetin elektrik pa kontratë, nga 5 000 deri në 20 000 lekë.

Në çdo rast, krahas gjobës, ka edhe detyrimin e shlyerjes së dëmit shkaktuar entit shpërndarës përkatës.

2. Kur shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni bëhen nga përdoruesit jofamiljarë, dënohen me gjobë si më poshtë:

- a) për lidhje abuzive para sistemit matës, nga 10 000 deri në 100 000 lekë;
- b) për cenim të sistemit matës dhe të vulave të tij, nga 10 000 deri në 300 000 lekë;
- c) për lidhje në rrjetin elektrik pa kontratë, nga 100 000 deri në 500 000 lekë;
- ç) për shtesë fuqie të instaluar mbi atë të deklaruar në kontratë, nga 5 000 deri në 50 000 lekë.

Në çdo rast, krahas gjobës, ka edhe detyrimin e shlyerjes së dëmit shkaktuar entit shpërndarës përkatës.

3. Për përcaktimin e saktë të vlerës së gjobës dhe të dëmit të shkaktuar entit shpërndarës përkatës, sipas llojit të shkeljes, madhësisë së fuqisë së instaluar në objekt dhe kohës së vërtetuar me shkelje, zbatohet tabela e penalteteve dhe e dëmeve, miratuar nga Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike.

4. Gjobat vendosen dhe vilen nga inspektorët e strukturës përgjegjëse për kontrollin e energjisë elektrike në KESH sha. Pagesa e gjobës bëhet brenda 10 ditëve nga data e vendosjes së saj.

5. Gjoha përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbartimit.

6. Kundër vendimit të dënimit me gjobë bëhet ankim me shkrim, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tij, tek titullari i strukturës përgjegjëse për kontrollin e energjisë elektrike, i cili duhet të shprehet me shkrim brenda 30 ditëve.

7. Me shpalljen e vendimit të mospranimin të ankimit bëhet menjëherë ndërprerja e furnizimit

me energji elektrike. Subjekteve, që nuk kanë bërë ankim me shkrim, u bëhet ndërprerja e energjisë elektrike.

8. Kundër vendimit të titullarit të strukturës përgjegjëse për kontrollin e energjisë elektrike mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 10 ditëve nga shpallja.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5355, datë 14.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu